


RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË DRAGASH

PROJEKTET E MONITORUARA

“NDËRTIMI I TROTUAREVE BRODOSANË-ZAPLLUXHE DHE BRRUT-BELLOBRAD”
“KUBËZIMI I RRUGËVE NË REGJIONIN E OPOJËS”

“NDËRTIMI I TROTUARIT DRAGASH - URA E FSHATIT SHAJNE”, “NDËRTIMI I MURIT
MBROJTËS TE VARREZAT E QYTETIT”, “NDRIÇIMI NË RRUGËN UNAZORE NË DRAGASH”
“ASFALTIMI E KUBËZIMI I RRUGËVE NË FSHATRAT E GORËS (RESTELICË DHE RADESHË)”





Nëntor 2025

Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË DRAGASH

PROJEKTET E MONITORUARA

“NDËRTIMI I TROTUAREVE BRODOSANË-ZAPLLUXHE DHE BRRUT-BELLOBRAD”

“KUBËZIMI I RRUGËVE NË REGJIONIN E OPOJËS”

“NDËRTIMI I TROTUARIT DRAGASH - URA E FSHATIT SHAJNE”, “NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS TE VARREZAT E QYTETIT”, “NDRIÇIMI NË RRUGËN UNAZORE NË DRAGASH”

“ASFALTIMI E KUBËZIMI I RRUGËVE NË FSHATRA E GORËS (RESTELICË DHE RADESHË)”



DEMOS Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë. Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar. Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje duke përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 16 projektet e përgjeshura në gjashtë komuna, Drenas, Lipjan, Istog, Dragash, Kaçanik dhe Mamushë.

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

AVOKO është një organizatë rinore që vepron në Komunën e Dragashit, e cila ka për mision fuqizimin e të rinjve përmes edukimit, trajnimit profesional dhe pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore. Organizata është e orientuar drejt zhvillimit të kapaciteteve të rinisë, me theks të veçantë te komunitetet rurale dhe multietnike, duke krijuar qasje të barabarta në mundësitë e arsimit joformal dhe inovacionit.

Në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, AVOKO ka luajtur rol kyç në përfshirjen e qytetarëve të rinj në procesin e Auditimit Social, duke ofruar trajnim dhe koordinim për ekipin prej 20 anëtarëve të Komunës së Dragashit.



PËRMBAJTJA

7	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
8	GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT
8	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i trotuareve Brodosanë - Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad”
9	Gjetjet specifike në projektin “Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës”
9	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne”, “Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit”, “Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash”
10	Gjetjet specifike në projektin “Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)”
11	AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL
13	KAPITULLI I - GJETJET E PËRBASHKËTA NË PROJEKTET E MBIKËQYRURA NË DRAGASH
17	KAPITULLI II - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I TROTUAREVE BRODOSANË-ZAPLLUXHE DHE BRRUT-BELLOBRAD”
21	KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “KUBËZIMI I RRUGËVE NË REGJIONIN E OPOJËS”
24	KAPITULLI IV - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I TROTUARIT DRAGASH - URA E FSHATIT SHAJNE”, “NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS TË VARREZAT E QYTETIT”, NDRIÇIMI NË RRUGËN UNAZORE NË DRAGASH”
27	PËRFUNDIME / REKOMANDIME
27	Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve
27	Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit
28	Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit
29	METODOLOGJIA
30	Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?
30	Si u grumbulluan të dhënat?
31	Validimi i të dhënave
31	Përbërja e ekipit
32	EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË DRAGASH
33	LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT
34	LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E DRAGASHIT

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, BIRN dhe OJQ Avoko lehtësuan procesin e themelimit të ekipit të “Auditimit Social” në Komunën e Dragashit. Brenda tre muajsh, ekipi u angazhua në mbikëqyrjen dhe analizimin e gjashtë projekteve investive me vlerë të përgjithshme mbi 435,000 euro, duke përfshirë: ndërtimin e trotuareve në Brodosanë-Zaplluzhë dhe Brrut-Bellobrad, kubëzimin e rrugëve në rajonin e Opojës, ndërtimin e trotuarit Dragash-Ura e Shajnës, ndërtimin e murit mbrojtës të varrezat e qytetit, ndriçimin e rrugës unazore në Dragash dhe asfaltimin e kubëzimin e rrugëve në fshatrat Restelicë dhe Radeshë në Gorë.

Ekipi i Auditimit Social punoi në grupe të veçanta për monitorimin në terren dhe pas përfundimit të projekteve, zhvilloi konsultime të përbashkëta për evidentimin e gjetjeve të përgjithshme dhe specifike për secilin projekt. Nga monitorimi u identifikuan një sërë çështjesh kryesore lidhur me transparencën, cilësinë e punimeve dhe respektimin e afateve kohore. Bazuar në këto gjetje, u përgatitën rekomandime konkrete për komunën për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe monitorimit të projekteve publike.

Komuna e Dragashit është një nga komunat përfituese të Grantit të Performancës Komonale. Për të rritur cilësinë e projekteve të financuara nga ky grant, një ekip aktivistësh të shoqërisë civile nga Dragashi, i mbështetur nga projekti DEMOS dhe MAPL, nisi në gusht 2025 nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike.

Auditimi Social në Kosovë ka filluar të aplikohet nga DEMOS dhe organizatat e shoqërisë civile që nga viti 2022 dhe është zhvilluar më tej gjatë viteve 2023–2025. Me mbështetjen e projektit DEMOS dhe MAPL-së janë themeluar 35 grupe me më shumë se 700 qytetarë aktivë.

Me mbi 700 anëtarë të përfshirë ndër vite, ekipet e Auditimit Social kanë ofruar mbi 200 rekomandime konkrete për përmirësimin e qeverisjes lokale dhe rritjen e transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, BIRN dhe D+ së bashku me gjashtë organizata lokale — HANDIKOS Istog, HANDIKOS Kaçanik, HANDIKOS Drenas, OJQ Avoko, YAHR dhe MAMUŞA EMEKÇI KADINLAR DERNEĞİ me mbështetjen e DEMOS dhe MAPL-së, themeluan gjashtë ekipe të Auditimit Social në komunat Dragash, Drenas, Lipjan, Mamushë, Kaçanik dhe Istog. Këto ekipe mbikëqyrën 16 projekte të komunave përfituese dhe u aftësuan përmes trajnimeve të specializuara në bazat e Auditimit Social, menaxhimin financiar dhe komunikimin strategjik.

Në Dragash, pas hulumtimit dhe konsultimeve me komunitetin, mbi 20 qytetarë u përzgjedhën për t’u bërë pjesë e ekipit të Auditimit Social. Trajnimet përfshinë ligjërime dhe praktikë në terren, duke përfshirë vendosjen e kontakteve me komunën, analizimin e dokumenteve dhe verifikimin e fakteve. Gjatë këtij procesi u kryen mbi 10 vizita në terren dhe mbi 10 takime zyrtare. Ekipi hartoi rekomandime konkrete, të cilat u ndanë me komunën dhe për të cilat Komuna e Dragashit u zotua për zbatimin e tyre.

Ky proces tregon rëndësinë e angazhimit qytetar në rritjen e transparencës, përmirësimin e menaxhimit të projekteve publike dhe fuqizimin e organizatave lokale në qeverisjen komonale.

GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT



Komuna e Dragashit nuk i ka zbatuar në plotni standardet e përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore dhe konsultimeve me qytetarët.



Në vendpunishtet ku janë implementuar projektet nuk ka pasur udhëzime të qarta për realizimin dhe detajet e projekteve, siç kërkohet nga udhëzimi i MAPL-së për transparencë.



Projektet investive nuk janë diskutuar në publik me qytetarët në fazën e planifikimit, dhe komuna nuk disponon të dhëna për konsultime të tilla me komunitetin.



Komuna nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për të siguruar vendpunishtet ku po zhvillohen punimet. Situata është edhe më problematike në zonat ku zhvillohet trafik dhe automjetet nuk janë të paralajmëruara për rrezikun.



Projektet kornizë, si trotuaret, janë realizuar pa planifikim të detajuar dhe kjo ka krijuar hapësira për gabime.



Në pjesën më të madhe të projekteve nuk janë planifikuar mbrojtje nga erozioni i cili në zonën e Dragashit është i madh për shkak të terrenit të vështirë.

Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i trotuareve Brodosanë - Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad”

Gjatë mbikëqyrjes së projektit të ndërtimit të trotuareve ekipi ka konstatuar se:



Projekti nuk është planifikuar siç duhet pasi në tërësinë e tij ka probleme për shkak se trotuari bëhet i papërdorshëm në zonën ku janë varrezat.



Trotuari nuk është i qasshëm për personat me aftësi të kufizuar dhe karroca dhe nuk ka planifikim të parkingjeve për këto kategori.



Trotuari nuk është i përshtatshëm për personat e verbër.



Cilësia e punimeve është e dobët dhe skajoret e trotuarit janë dëmtuar para se ato të pranohen teknikisht.



Në zonë kanë mbetur gurë dhe mbetje inerte nga punimet e zhvilluara.



Projekti nuk ka paraparë mbojtëse metalike dhe shenjzim të rrugës.

Gjetjet specifike në projektin “Kubëzimi i rrugëve në regionin e Opojës”

Gjatë mbikëqyrjes dhe vizitave në terren ekipi i Auditimit Social ka vizituar dhe mbikëqyrur projektin e kubëzimit të rrugëve. Gjatë vizitave janë konstatuar probleme sistematike, si:



Punimet janë realizuar pa tabelë informuese



Investimi është dëmtuar gjatë realizimit të punimeve



Për shkak se zona është zonë e pjerrët, ajo rrezikohet nga erozioni.



Në zonë nga investimi kanë mbetur mbetje inerte të cilat kanë ndotur ambientin.



Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne”, “Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit”, “Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash”

Ekipi i Auditimit Social ka marrë në trajtim edhe projektin e ndërtimit të murit mbrojtës dhe ndriçimit në rrugën unazore në Dragash dhe ka konstatuar se:



Projekti për ndriçimin ende nuk ka filluar mirëpo ekipi ka konstatuar se projekti është i domosdoshëm për zonën, për shkak të frekuentimit të rrugës gjatë verës.

Ekipi u fokusua në projektin e ndërtimit të murit mbrojtës tek varrezat e qytetit dhe konstatoi se:



Në zonë mungojnë shenjat dhe rrethojat për zonën e rrezikshme



Zona ka rrezik shembjeje për shkak të erozionit të tokës



Projekti ka dëmtuar projektet e tjera infrastrukturore, si dëmtimi i asfaltit



Ka mungesë konsistence në vendosjen e vrimave kulluese të murit

Gjetjet specifike në projektin “Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)”

Tenderi për projektin “Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve në Regjionin e Gorës (Restelicë dhe Radeshë) kishte dështuar dy herë me radhë në mungesë të ofertuesve. Tentativa e radhës ishte me 05.09.2025, e cila arriti të finalizohet me nënshkrim të kontratës. Kontrata me çmim të përgjithshëm 122,219 euro ju dha Operatorit Ekonomik “Gashi Ing 3” ShPK.

Në mes tjerash, projekti përfshin zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës Stratorje–Buka me faza të ndryshme si: pastrimi i terrenit, gërmimet, ndërtimi i kanaleve për ujërat atmosferikë, vendosja e tobinave, shtresat mbushëse dhe asfaltimi final.

Tutje, përfshin kubëzimin e rrugëve në fshatin Radeshë dhe Veljevir, asfaltimin e segmentit rrugor në fshatin Restelicë si dhe ndërhyrje në rrugët tjera sipas nevojës. Sipas Komunës së Dragashit, “punimet kane filluar dhe janë duke u zhvilluar sipas kontratës”¹

Për më tepër rreth këtij projekti, menaxheri i kontratës, Flurim Krasniqi, ka thënë se është duke u punuar me intensitet të shtuar.

Për shkak të kushteve klimatike, janë angazhuar që punët të kryhen në disa lokalitete. Sipas tij, në Restelicë, më 17.11.2025 është asfaltuar një distancë e vogël deri 200 metra. “Kubëzat në Radeshë gati janë të përfunduara”.

Ndonëse sipas menaxherit nuk ka pasë vonesë, pengesat kanë qënë evidente. “Si i kemi gërmu kanë dalë gypat. I kemi zëvendësuar gypat, kemi lidhë kanalizime, shumë sfida.”

Deri më 17.11.2025 janë realizuar mbi 50% e punimeve.²



ÇKA DUHET TË DIJË NJË EKIP I AUDITIMIT SOCIAL?

Ekipet e Auditimit Social nuk nevojitet të jenë skajshmërisht profesionale. Ekipet kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar; si dhe, rekomandohet të kenë njohuri të bazike, në:

- Funkionimin e Komunës;
- Qasjen në dokumente publike;
- Procesin e konsultimit me publikun - sidomos gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve në Komunë;
- Procesin e prokurimit publik.

¹ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025

² Menaxheri i Kontratës_Flurim Krasniqi_17.11.2025

AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Komuna e Dragashit, me një popullsi prej 28,896 banorësh, klasifikohet si komunë me madhësi pothuajse mesatare në Kosovë. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë REKOS2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)³ tregojnë se numri i banorëve të Dragashit është më i përafërt me Deçanin, Kaçanikun dhe Istogun.

Buxheti i komunës arrin në 12,822,214 euro⁴ nga i cili 4,404,326 euro janë ndarë për investime kapitale, duke përbërë rreth 34.37% të buxhetit të përgjithshëm.

Granti i Performancës Komunale është një mbështetje financiare që u jepet komunave pas vlerësimit të performancës së tyre në menaxhimin e qeverisjes lokale. Granti në baza vjetore vlerëson mbi 100 indikatorë ku përfshihen transparenca, ofrimi i shërbimeve publike, planifikimi buxhetor dhe zbatimi i projekteve zhvillimore.

Dragashi ka qenë ndër përfitueset e Grantit për Performancë Komunale. Si rezultat i menaxhimit të mirë dhe rezultateve të arritura, ajo është renditur me komunat përfituese të këtij granti, i financuar nga DEMOS dhe MAPL. Dragashi ka përfituar mbi 435 mijë euro për katër projekte.

Projekti “Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad”⁵ ishte paraparë të realizohej nëpërmjet Grantit të Performancës Komunale.

Projekti është ri-tenderuar më 1 korrik 2025, me publikimin e njoftimit për kontratë. Ritenderimi është bërë pasi aktiviteti paraprak ishte anuluar, për shkak se oferta e dorëzuar kishte tejkaluar buxhetin e parashikuar.

Pas përfundimit të procesit të ritenderimit me 30 korrik 2025 është nënshkruar Kontrata me operatorin ekonomik “Art Project” Sh.P.K, me vlerë 80,299.82 euro.

Me këtë projekt është paraparë përgatitja e terrenit, gërmimet, ngjeshja e bazës, vendosja e shtresave rrugore, kubëzave dhe bordurave, ndërtimi i kanaleve për ujërat atmosferikë, vendosja e tombinave, si dhe pastrimi dhe përfundimi i vendpunishtes.

Projekti tjetër është “Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës”. Tenderi u shpall më 27.05.2025, ndërsa aktiviteti i prokurimit finalizohet me nënshkrim të kontratës me Operatorin Ekonomik “Art Project” ShPK, me vlerë të kontratës 101,994.69 euro.

Projekti për kubëzimin e rrugëve në regjionin e Opojës përfshin furnizimin dhe vendosjen e materialeve cilësore sipas standardeve, me të gjitha punimet përkatëse: incizime, gërmime, transport, ndërtim të shtresave rrugore, vendosje të skajorëve dhe kubëzave të betonit. Në çmim përfshihen edhe kontrollet për instalimet nëntokësore dhe riparimi i tyre në rast dëmtimi.

Projekti tjetër ku Komuna e Dragashit kishte planifikuar t’i investojë paratë e grantit, është projekti “Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i trotuarit Dragash-fshati Kukajan, Ndërtimi i murit mbrojtës te varrezat e qytetit, si dhe ndërtimi i ndriçimit në rrugën Unazore në Dragash”.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës [ASK]_Regjistrimi i Popullsisë 2024: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ea5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf>

⁴ Ligji NR. 08/L-260 Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>



Ngjashëm me projektin e kubëzimit të rrugëve “Brut–Bellobrat dhe Brodosanë–Zaplluxhe”, edhe ky aktivitet prokurimi nuk arriti të përfundonte me nënshkrim kontrate në herën e parë, për shkak se oferta kishte tejkaluar buxhetin e parashikuar. Projekti është ritenderuar më 1 korrik 2025, ndërsa kontrata është nënshkruar më 30 korrik 2025 me Operatorin Ekonomik “Art Project” Sh.P.K., me vlerë të kontratës prej 135,329.28 euro. Operatori Ekonomik në fjalë po ashtu ka fituar edhe dy kontrata të tjera që janë pjesë e monitorimit nga ekipi i Auditimit Social.

Projekti parasheh ndërtimin e trotuareve në segmentet Dragash–Ura e fshatit Shajne dhe Dragash–fshati Kukajan, ndërtimin e ndriçimit rrugor në Unazën e qytetit, si dhe ndërtimin e një muri mbrojtës pranë varrezave të qytetit. Për çdo segment pritet të bëhen punimet, si punimet e dheut, mbi-struktura, kanalizimet, ndriçimi dhe punimet e betonit dhe armaturës.

Projekti gjithashtu përfshin punime të kanalizimit fekal përgjatë rrugës Dragash–Stadium, ku do të bëhen gërmime, instalimin e gypave dhe elementeve ndihmëse sipas standardeve inxhinierike dhe dokumentacionit teknik.

Tenderi për projektin “Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve në Regjionin e Gorës (Restelice dhe Radeshë) kishte dështuar dy herë me radhë në mungesë të ofertuesve. Tentativa radhës ishte me 05.09.2025, e arriti të finalizohet me nënshkrim të kontratës. Kontrata me çmim të përgjithshëm 122,219 euro ju dha Operatorit Ekonomik “Gashi Ing 3” ShPK.

Në mes tjerash, projekti përfshin zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës Stratorje–Buka me faza të ndryshme si: pastrimi i terrenit, gërmimet, ndërtimi i kanaleve për ujërat atmosferikë, vendosja e tombinave, shtresat mbushëse dhe asfaltimi final.

Tutje, përfshin kubëzimin e rrugëve në fshatin Radeshë dhe Veljevir, asfaltimin e segmentit rrugor në fshatin Restelicë si dhe ndërhyrje në rrugët tjera sipas nevojës.

KAPITULLI I

GJETJET E PËRBASHKËTA NË PROJEKTET E MBIKËQYRURA NË DRAGASH



Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me mbështetjen e projektit DEMOS në vitin 2023 ripërcaktoi normativën ligjore mbi të cilën komunat e vendit zhvillonin procesin e konsultimit me qytetarët. Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna përcaktoi standarde të avancuara në të cilat komunat organizojnë konsultimet me qytetarët dhe i publikojnë të dhënat publike.

Mbi këtë udhëzim komunat zhvillojnë takime me qytetarët me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të tyre në vendimmarrje. Sipas parimeve, Komuna konsulton qytetarët nëpërmjet:

- Takimeve publike;
- Konsultimit publik për projekte, aktet normative dhe dokumente të politikave;
- Takime konsultative me qytetarë;
- Dëgjime buxhetore.

Ekipi i Auditimit Social gjatë programit të trajnimeve u pajis me njohuri për obligimet e autoriteteve lokale për të zhvilluar procesin e konsultimeve publike dhe mbi këto parime kontrolloi nëse Komuna e Dragashit kishte zbatuar standardet minimale të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur.

Vitet e fundit, Komuna e Dragashit ka bërë përparim në përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, përmes organizimit të konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore. Ky proces ka ndihmuar që zëri i qytetarëve të dëgjohet dhe të përfshihet më shumë në planifikimet komunale.

Një përmirësim i konsiderueshëm është vërejtur edhe në përfshirjen gjinore në këto konsultime, edhe pse ky aspekt ende nuk është në nivelin e dëshiruar.

Në përgjigjen zyrtare të komunës thuhet se është e angazhuar që në të ardhmen të sigurojë një përfaqësim më të barabartë gjinor në të gjitha fazat e konsultimeve publike.

Kërkesat e qytetarëve, të mbledhura nëpërmjet takimeve publike apo formave të tjera të komunikimit, janë reflektuar në buxhetin komunal. Shumica e tyre janë përfshirë dhe realizohen përmes kategorive të ndryshme buxhetore, veçanërisht në fushat e investimeve kapitale, subvencioneve dhe shërbimeve publike.

Për të lehtësuar përfshirjen, Komuna e Dragashit ka ofruar opsione të ndryshme për qytetarët, duke përfshirë takimet fizike dhe konsultimet elektronike përmes platformave zyrtare dhe kanaleve të komunikimit me OJQ-të dhe grupet e interesit.

Komuna zotohet se proceset e konsultimeve publike janë zhvilluar në përputhje me standardet ligjore dhe praktikën e zbatuar në të gjitha komunat e Kosovës. Komuna ka siguruar transparencë të plotë në këtë proces, duke publikuar të gjitha materialet relevante, njoftime, dokumente, procesverbale dhe raporte në platformat e saj zyrtare.

Nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në terren, ekipi i Auditimit Social konstatoi probleme që lidhen me planifikimin, procedurat e kontraktimit dhe zbatimin praktik të projekteve, duke përfshirë vonesa, mungesë të cilësisë së nevojshme dhe kërkesën për investime shtesë.

Nga analizi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, ekipi konstatoi se kërkesat e personave me aftësi të kufizuara nuk refletohen në kërkesat e qytetarëve të tjerë.

Po ashtu u konstatua se kërkesat regjistrohen nga komuna në një formë protokolare pa një arsyeshmëri se pse po bëhen kërkesat nga qytetarët.



Gjetjet në diskutimin e projekteve investive

Neni 17 i Udhëzimit për Administratë të Hapur në Komuna ka promovuar standardin që projektet investive të diskutohen me komunitetin në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Mbi këtë standard, hartuesit e projekteve dhe komunat do t'i diskutonin projektet para nisjes së implementimit të tyre me qëllim që projektet të jenë të plota dhe të familjarizuara për tërë komunitetin.

Mbi këtë standard, para nisjes së procesit të prokurimit dhe gjatë fazës së hartimit të projektit, komunat do të organizonin takime me qytetarët për të prezantuar projektin, mjetet në dispozicion dhe ndikimin e tij në komunitetin lokal.

Nga të dhënat e Komunës së Dragashit, ekipi i Auditimit Social gjeti se projektet konkrete “Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad”, “Kubëzimi i rrugëve në regionin e Opojës”, “Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne”, “Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit”, “Ndriçimi

në rrugën unazore në Dragash”, si dhe “Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)”, janë kërkesa të vazhdueshme të qytetarëve, të shprehura në dëgjimet publike apo përmes përfaqësuesve lokalë.

Kjo kërkesë e qytetarëve është konfirmuar edhe nga Komuna e Dragashit. “Po, këto kanë qenë kërkesa të vazhdueshme të qytetarëve. Këto projekte kanë ardhur si rezultat e mbledhjes së një sërë kërkesash, qoftë përmes dëgjimeve publike me qytetarë, qoftë si kërkesa me shkrim apo verbale nga këshillat dhe përfaqësuesit e fshatrave dhe lokaliteteve.”⁵

Megjithatë, pas vendimit për realizimin e këtyre projekteve, komuna nuk ka organizuar takime të veçanta për të diskutuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetarët rreth vërejtjeve, sugjerimeve apo rekomandimeve të tyre për këto projekte specifike.



5 Komuna e Dragashit_Përgjigje me shkrim_12.09.2025



Gjetjet në zbatimin e obligimit për të njoftuar qytetarët

Udhëzimi Administrativ për Administratën e Hapur të komunave kërkon nga autoritetet lokale që për të gjitha projektet investive komuna t'u ofrojë qytetarëve informacione të mjaftueshme për projektin. Mbi këto parime, komunat duhet të publikojnë kontratat dhe projektet investive në faqet e tyre zyrtare duke u mundësuar qytetarëve qasje në to.

Ekipi ka vërejtur se kontratat e projekteve janë të qasshme në platformën e E-prokurimit, ku gjithashtu figurojnë disa informacione tjera lidhur me to. Megjithatë, komuna nuk ka bërë publike projektet ekzekutive, as dokumentacionin mbështetës të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë faturat, situacionet e punimeve të kryera dhe të paguara, ndryshimet e mundshme dhe arsyetimin e atyre ndryshimeve.

Ligji për Prokurimin Publik e bën transparencën parim bazë dhe kërkon që autoritetet kontraktuese të publikojnë dokumentet kryesore të procedurës së prokurimit, ndërsa për dokumentet e ekzekutimit të kontratës të sigurojnë qasje me kërkesë nga publiku. Kjo përfshin plane, specifikime dhe dokumente që lidhen me menaxhimin e kontratës, për sa këto nuk përmbajnë informata të klasifikuara si sekret tregtar. Në këtë kuadër, plani i menaxhimit të kontratës dhe dokumentet që lidhen me monitorimin e saj konsiderohen dokumente të qasshme ligjërisht.

Raportet e menaxherit të kontratës, vlerësimet e performancës dhe dokumentet operative të ekzekutimit nuk publikohen automatikisht, por mund t'u jepen qytetarëve me kërkesë zyrtare, në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente publike. E njëjta vlen edhe për faturat dhe pagesat: edhe pse nuk publikohen në mënyrë të rregullt në platformën e prokurimit, ato janë pjesë e dokumenteve të ekzekutimit të kontratës që mund të kërkohen dhe shpërndahen, përveç kur përmbajnë informata të mbrojtura.

Andaj, ekipi i Auditimi Social rekomandon që komuna të avancojë transparencën, duke publikuar në mënyrë proaktive edhe dokumentet ekzekutive të kontratave, si

projektet ekzekutive, përshkrimet teknike, raportet e menaxhimit dhe të dhënat kryesore mbi pagesat. Në praktikë, disa autoritete kontraktuese tashmë e kanë bërë këtë, duke publikuar projekte ekzekutive dhe dokumentacion teknik, çka ka rezultuar në rritjen e llogaridhënies dhe besimit publik. Kjo qasje do të ishte një praktikë e mirë edhe për komunën, pasi rrit dukshëm transparencën dhe ul hapësirën për keqinterpretime apo dyshime gjatë realizimit të kontratave publike. Kjo mungesë transparence e pamundëson monitorimin nga qytetarët në zbatimin e projektit.

Tri nga katër projektet përveç projektit të "Kubëzimit të rrugëve në regjionin e Opojës" kanë kaluar nëpër fazën e ritenderimit, kryesisht për shkak të ofertave që tejkaluan buxhetin apo mungesës së ofertuesve, çka tregon sfida të përsëritura në procesin e prokurimit. Një element tjetër i përbashkët është se në shumicën e kontratave, fitues ka qenë i njëjti operator ekonomik "Art Project" ShPK.

Gjatë takimeve me menaxherët e kontratave dhe me vetë kryetarin e Komunës së Dragashit, ekipi evidentoi se komuna përballet me mungesë të interesimit nga operatorët ekonomikë për të marrë punë në këtë komunë, shtu këtu edhe ofertat e kompanive që tejkaluan vlerën e parashikuar të projekteve.

Për pasojë, ekipi konstatoi se kjo mund të jetë arsyeja pse komuna detyrohet të kontraktojë një operator ekonomik në më shumë se një kontratë.

Ekipi rekomandon që komuna të bëjë planifikim më kohë dhe më të kujdesshëm të projekteve, me vlerësime reale të kostove dhe përgatitje të dokumentacionit tenderues me kohë. Po ashtu, duhet të merren masa për rritjen e konkurrencës në tenderë, nëpërmjet konsultimeve me tregun dhe rishikimit të kriterëve teknike. Këto veprime janë të domosdoshme për të shmanhur vonesat dhe rrezikun e humbjes së fondeve për shkak të procedurave të pasuksesshme të prokurimit.

Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna

Për çdo projekt, komuna vendos pano informuese për aktivitetin e prokurimit, në të cilën shkruhet emri i projektit, investitori, kompania implementuese dhe kohëzgjatja. Me qëllim të rritjes së transparencës, komuna duhet të vendosë emrin, mbiemrin dhe kontaktet e menaxherit, mbikëqyrësit apo kompanisë mbikëqyrëse të projektit.

Në këtë situatë, ekipi ka analizuar edhe transparencën e projekteve në vendin ku ato ishin duke u zhvilluar. Sipas UA-së, komuna duhet të vendosë në secilën vendpunishte

pano informuese në të cilat përmendet qartë investitori dhe emërohet personi i cili mbikëqyr kontratën.



Gjetjet në sigurinë e vendpunishtes

Ekipi i Auditimit Social, gjatë vizitave në terren, ka konstatuar se Komuna e Dragashit nuk ka siguruar zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë në disa vendpunishte publike nën përgjegjësinë e saj. Në disa zona ku janë zhvilluar punime në rrugë nuk janë vendosur shenja paralajmëruese apo sinjalizime për punimet në zhvillim. Po ashtu, nuk janë vendosur udhëzime apo paralajmërime për rreziqet potenciale. Po ashtu punëtorët në vendpunishte u panë se nuk ishin të pajisur me të gjitha mjetet mbrojtëse [helmeta, jelekë me shirita ndriçues, syze mbrojtëse për punë].

Konstatimi është edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh se ligji obligon kompanitë dhe organet përgjegjëse të ndër marrin masa për të siguruar vendpunishtet, duke garantuar që ato të jenë të rrethuara, të sinjalizuara dhe të ofrojnë udhëzime për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet. Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor rrit ndjeshëm rrezikun për aksidente dhe dëmtime fizike.

Mungesa e masave të sigurisë në vendpunishtet publike paraqet rrezik serioz për sigurinë e qytetarëve dhe punëtorëve. Zonat e pambrojtura dhe pa sinjalizim mund të shkaktojnë aksidente, rënie ose lëndime fizike, përfshirë dëmtime të mjeteve, dhe krijojnë rrezik për përgjegjësi ligjore dhe financiare për komunën, si dhe dëmtojnë reputacionin e institucionit për moszbatim të standardeve bazë të sigurisë dhe mbrojtjes në punë.



KAPITULLI II

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I TROTUAREVE BRODOSANË-ZAPLLUXHE DHE BRRUT-BELLOBRAD”

Projekti “Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad”, që financohet nga Granti i Performancës Komunale, u ritenderua më 1 korrik 2025, pasi tenderi i parë ishte anuluar për shkak se ofertat kishin tejkaluar buxhetin e planifikuar.

Më 30 korrik 2025 u nënshkrua kontrata me “Art Project” Sh.P.K., me vlerë 80,299.82 euro, duke mundësuar fillimin e realizimit të projektit. Menaxher i Kontratës është emëruar Flurim Krasniqi, të cilit u janë dorëzuar me kohë dokumentet e nevojshme nga Zyra

e Prokurimit dhe ka përpiluar Planin e Menaxhimit të Kontratës. Sipas Krasniqit, nuk ka pasur ankesa, dhe ecuria e projektit ka qenë e rregullt.⁶

Deri me datë 25 shtator 2025, punët e realizuara janë punimet e dheut, në trotuarin në rrugën Brut-Bellobradë, është bërë mbushja materiale dhe guroret dhe rreth 60-70 % e anësorëve janë vendosur⁷.

Gjatë vizitës në vendpunishten ku po ndërtohet trotuari Brrut-Bellobrad, ekipi konstatoi gjetjet si më poshtë.



Mosplanifikimi i tabelës informuese

Gjatë vizitës në terren, ekipi i Auditimit Social konstatoi se në vendpunishte mungon tabela informuese me të dhënat bazë të projektit, duke përfshirë emrin e projektit, vlerën, investitorin, punëkryesin dhe mbikëqyrësin.

Në takimin me Menaxherin e Kontratës, u sqarua se vendosja e tabelës është pjesë e marrëveshjes së grantit për komunën dhe se operatori ekonomik është i obliguar t’i sjellë tabelat. Aktualisht po pritet përcaktimi i lokacioneve të përshtatshme për vendosjen e tyre, pasi një projekt mund të ketë dy ose tre vendpunime të ndara.

Mosvendosja e tabelës informuese në vendpunishte pengon transparencën dhe informimin e drejtë të qytetarëve mbi të dhënat kryesore të projektit. Vendosja e tabelave të tilla është e domosdoshme për të siguruar qasje në informacion publik dhe për të rritur llogaridhënien në procesin e zbatimit të projekteve.

Në përgjigjen e Komunës është zotuar që së shpejti do të vendoset tabela informuese për këtë projekt.

⁶ Takimi i Ekipit të Auditimit Social në Dragash me Menaxherë të Kontratave_25.09.2025

⁷ Flurim Krasniqi_Menaxher i Kontratës_25.09.2025



Punimet në rrugë pa masa të sigurisë dhe sinjalistikë

Gjatë vizitës në terren, ekipi konstatoi mungesën e shiritave dhe rrethojave të sigurisë në vendpunishte, si dhe mungesën e sinjalistikës paralajmëruese për shoferët që qarkullojnë pranë zonës së punimeve. Përfundimisht bën vetëm një shenjë rreziku në formë trekëndëshi e vendosur në hyrje të projektit, e cila nuk është e mjaftueshme për të garantuar sigurinë e pjesëmarrësve në komunikacion.

Menaxheri i kontratës, Valmir Krasniqi, deklaroi se sinjalizimet ishin vendosur më herët, por janë larguar nga persona të pandërgjegjshëm:

“Shiritat sinjalizues kanë ekzistuar, mirëpo janë larguar edhe shenjat e punimeve në rrugë. Po i heqin njerëzit e pandërgjegjshëm.”

Mungesa e elementeve të sigurisë në vendpunishte paraqet rrezik për punëtorët dhe qytetarët që lëvizin në afërsi të zonës së punimeve. Edhe pse sinjalistika është vendosur më herët, mirëmbajtja dhe siguri i saj mbetet i domosdoshëm për të garantuar siguri, për të shmangur aksidentet dhe për të respektuar standardet e sigurisë në punë dhe në trafik.



Cilësia e punimeve dhe dëmtimet

Gjatë vizitës në terren, ekipi ka konstatuar se rreth 20 anësore të trotuarit janë plasaritur, thyer dhe dëmtuar gjatë punimeve. Këto dëmtime përfshijnë çarje dhe grisje të dukshme në sipërfaqet e anësoreve. Nëse këto anësore të dëmtuara lejohen të mbeten të vendosura, ekziston rreziku që ato të dëmtohen edhe më shumë gjatë periudhave me ngrica, për shkak të depërtimit të ujit dhe zgjerimit të akullit në çarje.

Në bazë të gjendjes së konstatuar, rekomandohet që anësoret e dëmtuara të mos

pranohen teknikisht, pasi nuk përmbushin standardet e cilësisë së kërkuar. Kërkohej nga Komuna që të obligojë operatorin ekonomik për sanimin dhe zëvendësimin e të gjitha anësoreve të dëmtuara, në mënyrë që të sigurohet cilësi, jetëgjatësi dhe përputhshmëri me kushtet teknike të projektit.

Komuna thotë se projekti ende nuk ka përfunduar dhe deri në fund të projektit gjithçka që është e dëmtuar do të rregullohet.⁸



⁸ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025



Trotuari i ngushtë dhe jo i qasshëm për personat me karroca

Gjatë vizitës në terren, ekipi i Auditimit Social konstatoi se trotuari aktual është i ngushtë dhe i papërshtatshëm për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për karrocet e fëmijëve. Në përballë-kalim të mundshëm, hapësira e trotuarit rezulton e pamjaftueshme. Menaxheri i Kontratës deklaroi se trotuari ka gjerësi 1.20 metra dhe është në përputhje me normat ligjore.

Ekipi rekomandon të shqyrtohet mundësia për ndërhyrje në projekt, në mënyrë që trotuari

të bëhet i qasshëm për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ndërtimin e pjerrinave të nevojshme. Po ashtu, është rekomanduar të sigurohet parking i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet e qasjes universale.

Ndërsa në anën tjetër nga komuna thonë se trotuari është i vendosur jashtë fshatit në rrugën që i lidhë dy fshatrat dhe trotuari është në nivelin 0 të rrugës dhe ka qasje për karroca për personat me aftësi të kufizuar.⁹



Mosplanifikimi i duhur i projektit

Gjatë vizitës në terren ekipi ka identifikuar se muri përgjatë varrezave ndan dy pjesët e trotuarit, gjë që detyron qytetarët të kalojnë në asfalt për të kaluar nga njëra anë në tjetrën, duke rrezikuar sigurinë e tyre për shkak të qarkullimit të automjeteve me shpejtësi.

Më parë ishte bërë një analizë për të gjetur një zgjidhje për situatën e murit, por sipas menaxherit të kontratës, vendimi përfundimtar nuk varet nga ta. Ata po shqyrtojnë pjesën mbi mur, duke parë sa varrezat ndodhen pranë tij, dhe po mendojnë një mënyrë për të kaluar sipër murit me një pjerrinë dhe për t'u kthyer prapë: *“Problemi është te varrezat, nëqoftëse nuk kemi varreza afër, atëherë mund të nxirret një trotuar. Se ne nuk guxojmë nën 1.20 gjatësi trotuar. Se është normativë dhe nuk guxojmë, me ligj e kemi të ndaluar. Për atë arsye është e pamundur në gjendjen që është me u bo trotuari.”*

Si option tjetër ishte menduar të ndërtohej trotuari poshtë rrugës, por për shkak të pjerrësisë së terrenit, do të ishte e nevojshme që fillimisht të ndërtohej një mur mbrojtës për të gjithë trotuarin. Vendi është shumë i ngushtë vetëm 1.70 metra nga rruga, ndërsa trotuari do të duhej të bëhej 1.20 metra gjerësi.

Ekipi rekomandon gjetjen e një zgjidhjeje për lidhjen e të dy pjesëve të trotuarit.

Sa i përket planifikimit të projektit në trotuarin Brrut - Bellobrad, Menaxheri i Kontratës, Flurim Krasniqi, ka thënë se kanë bërë një projekt me trotuare për lehtësimin e ecjes së këmbësorëve nëpër trotuare sepse ka pasë nevojë. *“Në vendin ku janë varrezat aty ka ekzistuar një mur mbrojtës që një kohë të gjatë dhe nuk kemi ndërhyrë për shkak të varrezave e kjo nuk do të thotë se nuk kemi bërë planifikim të mirë. Në të ardhmen në bisedime me fshatin do të shohim ndonjë alternativë për përfundimin e trotuarit në tërësi në vendin ku është muri i varrezave.”*¹⁰



⁹ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025

¹⁰ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025



Ndotja anësore e ambientit

Ekipi pas vizitës në terren ka konstatuar se gjatë punimeve nuk është bërë pastrimi i vendpunishtes dhe krasitja e pemëve; disa shtylla elektrike janë të mbuluara dhe pengojnë ndriçimin.

Përfaqësuesit e Komunës së Dragashit u zotuan se do të pastrohet. Ndërsa për prerjen e drunjve është një kontratë e mirëmbajtjes me një kompani tjetër, e cila pritet të dalë dhe të presë degët e drunjve që janë pengesë.

Rekomandohet që të pastrohet zona nga shkurret dhe të parandalohet rrëshqitja e dheut.

Për këtë çështje Komuna e Dragashit sqaron se “gjatë zhvillimit të punimeve mund të ketë mbeturina të ngurta mirëpo në momentin që flasim shumica e këtyre mbetjeve janë pastruar dhe terreni është i pastër.”

Një rekomandim tjetër që lidhet me pastërtinë publike, Ekipi e dha për vendosjen e shportave të mbeturinave, por menaxheri theksoi ndërgjegjësimin e qytetarëve. Ai shpjegon rastin ku janë ndërtuar rreth 70 shtëpi pushimi dhe secila ka 3-4 shporta, mbeturinat prapë hidhen në rrugë pranë shportës.



Mosplanifikimi i sinjalistikës rrugore

Për shkak të frekuentimit të lartë të zonës, ekipi i Auditimit Social e sheh të nevojshme vendosjen e shpeshtë të sinjalistikës rrugore, kufizimin e shpejtësisë dhe pengesave për ngadalësimin e qarkullimit, me qëllim shmangien e aksidenteve.

Për rregullimin e kësaj çështje, ekipi mësoi se komuna po has probleme me ministrinë përkatëse, sepse çështja trajtohet nga ajo. Në takim u tha se kërkesat u janë bërë disa herë, madje në fshatin Blaq janë vendos dhe nga ministria kanë shkuar ta heqin.

Andaj ekipi i rekomandoi Komunës që të argumentojë dhe dokumentojë kërkesat për të diskutuar më pas në Ministri për zgjidhjen e problemit.

Projekti nuk ka paraparë mbojtëse metalike dhe shenjzim të rrugës. Nga Komuna japin këtë arsye. “E kemi parë të arsyeshme që nuk duhet të ketë mbrojtëse metalike sepse shumica e projekteve janë zhvilluar jashtë vendbanimeve ndërsa mbrojtëset metalike kryesisht vendosen në vendbanime. Si dhe për llojin e punës që e kemi bërë nuk janë të nevojshme.”¹¹



Përkeqësimi i motit rrezikon përfundimin e punimeve brenda afatit

Për shkak të stinës së vjeshtës, e cila karakterizohet nga reshjet, ekipi shpreh shqetësimin për përkeqësimin e motit, që mund të shkaktojë vonesa në zhvillimin e punimeve, shtu këtu faktin se e njëjta kompani ka edhe dy kontrata të tjera në implementim.

Nga Menaxheri i Kontratës nuk shihet aq sfiduese “besoj që po, se nuk është një punë sfiduese e madhe që mos me u realizu.”¹²

Ekipi rekomandon që të ndërmerren veprimet e nevojshme, të shtohet intensiteti i punimeve për të shmangur vonesat në zbatimin e Kontratës.

¹¹ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025

¹² Flurim Krasniqi_Menaxher i Kontratës_25.09.2025

KAPITULLI III

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “KUBËZIMI I RRUGËVE NË REGJIONIN E OPOJËS”

Projekti “Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës”, u kontraktua në vlerë 101,994.69 me Operatorin Ekonomik “Art Project” ShPK.

Projekti për kubëzimin e rrugëve në regjionin e Opojës përfshin furnizimin dhe vendosjen e materialeve cilësore sipas standardeve, me të gjitha punimet përkatëse: incizime, gërmime, transport, ndërtim të shtresave rrugore, vendosje të skajoreve dhe kubëzave të betonit. Në çmim përfshihen edhe kontrollet për instalimet nëntokësore dhe riparimi i tyre në rast dëmtimi.

Për këtë kontratë, dokumentacioni për menaxhim i është dorëzuar menaxherit me kohë, dhe punimet kanë filluar gjithashtu në kohë dhe sipas kontratës. Sipas menaxherit të kontratës, punët e para nisën në fshatin Brezne. “Rrugën e parë që e kemi bërë, është rruga e fshatit Brezne, diku në vlerë 18 mijë euro vetëm ajo rrugë. Kam rrugën në Blaq, rrugica, rrugë, kam fshatin Bresanë, Kuklibeg, Kabre dhe Plavë.”¹³

Sipas Menaxherit të Kontratës, deri më 25.09.2025, punimet janë realizuar rreth 40%, dhe janë dërguar për pagesë 37,000 euro, nga vlera totale e kontratës prej rreth 102 mijë euro.

Ekipi i Auditimit Social realizoi një vizitë¹⁴ edhe në fshatrat Kapre dhe Kuklibeg të Komunës së Dragashit në javën e parë të tetorit, ku është planifikuar rregullimi i rrugëve përmes projektit “Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës”. Megjithatë, gjatë vizitës në terren dhe bisedave me banorët e zonës, u konstatua se punimet në këto lokalitete ende nuk kishin filluar.

Në përgjigjen e Menaxherit të Kontratës, Ylli Qafleshi, thuhet se punimet në fshatin Kapre dhe Kuklibeg, kanë përfunduar në javën e dytë të nëntorit. Sipas Menaxherit, janë realizuar punime në dy akse në fshatin Kuklibeg. Vlera e punëve në aksin e parë është 4218.7 euro ndërsa në aksin dytë vlera e punëve të realizuara është 2839.20 euro.¹⁵



13 Ylli Qafleshi_Menaxher i Kontratës_25.09.2025

14 Vizita e Ekipeve të Auditimit Social në Dragash_08.10.2025

15 Menaxheri i Kontratës_Ylli Qafleshi_17.11.2025



Punimet pa tabelë informuese

Ekipi gjatë vizitës në fshatin Brezne evidentoi se edhe në këtë vendpunishte mungon tabela informuese me të dhënat e projektit (emri, vlera, investitori, punëkryesi).

Ekipi rekomandoi që Komuna të marrë masa për vendosjen e tabelës me kohë dhe

njëkohësisht, të sigurohet që në të ardhmen mos të përsëriten në projektet e tjera.

Komuna e Dragashit është zotuar për vendosjen e saj. “Tabela informuese do të vendoset shumë shpejt dhe para përfundimit të projektit, gjithsesi që do të jetë e vendosur.”




Materiale inerte dhe mbeturina ndërtimore në vendpunishte

Gjatë inspektimit të vendpunishtes, ekipi konstatoi se kompania përgjegjëse nuk ka larguar materialet inerte dhe mbeturinat ndërtimore, duke mos respektuar standardet e sigurisë dhe të punës në terren. Gjendja aktuale paraqet rrezik për punonjësit dhe nuk respekton kërkesat e ruajtjes së ambientit.

Po ashtu, rruga përreth vendpunishtes nuk ka të vendosur sinjalistikë rrugore ose shenjzime të nevojshme, çka paraqet rrezik për qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve.

Ekipi rekomandon pastrimin e zonës dhe vendosjen e sinjalistikës adekuate për të garantuar sigurinë dhe rregullin në terren.

Në lidhje me këtë rekomandim të ekipit të Auditimit Social, Komuna e Dragashit ka thënë se mbetjet inerte në rrugët që kanë përfunduar janë larguar.¹⁶



Dëmtime të anësoreve të betonit, rekomandohet rregullimi i tyre

Gjatë mbikëqyrjes, ekipi ka evidentuar se disa nga anësoret e trotuareve janë të çara dhe të grisura, duke treguar se cilësia e punimeve nuk është e kënaqshme. Dëmtimet e konstatuara rrezikojnë jo vetëm qëndrueshmërinë e trotuarit, por edhe sigurinë e përdoruesve. Ato eliminojnë mundësinë e qasjes së sigurtë për personat me aftësi të kufizuara dhe e bëjnë të vështirë lëvizjen për fëmijët me karroca.

Gjendja aktuale mund të përkeqësohet gjatë dimrit për shkak të ngricave, pasi uji që depërton në çarje mund të shkaktojë zgjerim dhe thyerje të mëtejshme të materialit, duke rritur rrezikun e aksidenteve dhe shpenzimet për riparime.

Për këto arsye, rekomandohet ndërhyrje urgjente për rregullimin dhe zëvendësimin e anësoreve të dëmtuara, në mënyrë që të ruhet cilësia e punimeve, të sigurohet qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe të garantohet lëvizja e sigurtë për të gjithë këmbësorët.

Komuna e Dragashit garanton se asnjë investim nuk është dëmtuar gjatë realizimit të punimeve dhe ofron mundësinë për verifikim në terren.¹⁷

¹⁶ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025

¹⁷ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025



Rruga u ndërtua në zonë të pambrojtur nga erozioni

Gjatë inspektimit, ekipi ka konstatuar se kanali i ujit, i cili ndodhet në anën e majtë të projektit, mund të dëmtohet nga erozioni i ujërave, duke rrezikuar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e punimeve. Zona përreth kanalit është aktualisht e pambrojtur dhe nuk ofron mbrojtje adekuate kundër erozionit.

Për këtë arsye, ekipi rekomandon ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e erozionit, përfshirë përforcimin e brigjeve të

kanalit dhe implementimin e sistemit të duhur mbrojtës, në mënyrë që të ruhet integriteti i projektit dhe të shmangen dëmtimet e mundshme në të ardhmen.

Ndryshe nga ajo çfarë ekipi ka parë në teren, në përgjigjen me shkrim të datës 13.11.2025, nga Komuna e Dragashit thuhet se “në këtë projekt nuk ka asnjë zonë të pjerrët dhe nuk rrezikohet asnjëra udhë nga erozioni.”



Fotografi: Rruga në fshatin Brezne



Cilësi e dobët e punimeve në fshatin Blaq

Gjatë vizitës në terren në fshatin Blaq, ekipi i Auditimit Social konstatoi se anësoret e betonit nuk janë vendosur në mënyrë të duhur, duke krijuar hapësira të dukshme ndërmjet tyre, të cilat jo vetëm dëmtojnë pamjen estetike të trotuarit, por edhe reduktojnë qëndrueshmërinë e tij dhe rrisin rrezikun për këmbësorët, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që lëvizin me karroca.

Po ashtu, u evidentuan raste me dallime të dukshme në nivel dhe disnivele, të cilat tregojnë për mungesë të përputhshmërisë me standardet teknike dhe cilësore të projektit. Këto parregullsi rrisin mundësinë

e aksidenteve, si rrëshqitjet e këmbësorëve gjatë lëvizjes, dhe ndikojnë negativisht në funksionalitetin dhe sigurinë e trotuarit në përgjithësi.

Duke pasur parasysh këto gjetje, është e domosdoshme ndërhyrja për të rregulluar anësoret, për të eliminuar dallimet në nivel dhe për të siguruar që trotuari të jetë i qëndrueshëm, i sigurt dhe në përputhje me standardet ligjore dhe teknike. Një ndërhyrje e tillë do të garantonte qasje të sigurtë dhe të lehtë për të gjithë përdoruesit, do të parandalonte dëmtime të mëtejshme dhe do të ruante cilësinë dhe integritetin e punimeve të kryera.

KAPITULLI IV

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I TROTUARIT DRAGASH - URA E FSHATIT SHAJNE”, “NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS TE VARREZAT E QYTETIT”, NDRIÇIMI NË RRUGËN UNAZORE NË DRAGASH”

Projekti nëpërmjet të cilit ndërtohet rruga Dragash - Ura e fshatit Shajne, pastaj trotuari Dragash-fshati Kukajan, ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, si dhe ndërtimi i ndriçimit në rrugën Unazore në Dragash pati sfida në procesin e tenderimit për shkak se oferta kishte tejkaluar buxhetin e parashikuar. Kontrata për këtë projekt u nënshkrua më 30 korrik 2025 me Operatorin Ekonomik “Art Project” Sh.P.K, vlere e së cilës është 135,329.28 euro. Komuna ka emëruar Xhylbehar Taipin si menaxher të kësaj kontrate.

Projekti parasheh ndërtimin e trotuareve në segmentet Dragash–Ura e fshatit Shajne dhe Dragash–fshati Kukajan, ndërtimin e ndriçimit rrugor në Unazën e qytetit, si dhe ndërtimin e një muri mbrojtës pranë varrezave të qytetit. Për çdo segment pritet të bëhen punimet si punimet e dheut, mbi-struktura, kanalizimet, ndriçimi dhe punimet e betonit dhe armaturës.

Projekti gjithashtu përfshin punime të kanalizimit fekal përgjatë rrugës Dragash–Stadium, ku do të bëhen gërmime, instalimin e gypave dhe elementeve ndihmëse sipas standardeve inxhinierike dhe dokumentacionit teknik.

Në takimin e ekipit të Auditimit Social me menaxherin e kontratës të mbajtur më 25.09.2025, ai ka njoftuar se punët kanë filluar më 04.08.2025 dhe do të përfundojnë brenda afatit të paraparë, në nëntor.”¹⁸

Në takimin e ekipit të Auditimit Social me kryetarin e Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini, të mbajtur më 12.11.2025, menaxheri i kësaj kontrate, Xhylbehar Taipi, tha se ndërtimi i murit ka përfunduar. “Ka qenë i paraparë ndërtimi i murit në gjatësi 160 metra, dhe projekti është përfunduar me të gjitha normat e parapara për këtë lloj të projektit.”

Për përfundimin e tërësishëm të projektit ai ka thënë se është edhe faza tjetër e cila e përfshinë edhe mbushjen pas murit mbrojtës. Menaxheri ka njoftuar ekipin se për të përfunduar punët e tilla, duhet të kalojë një periudhë e caktuar, teknikisht diku rreth 28 ditë për t’u forcuar muri.

Sa i përket projektit të ndriçimit publik, menaxheri i kontratës ka thënë se i ka dërguar kompanisë së kontraktuar një e-mail, në të cilën ka kërkuar që punimet për ndriçimin publik të fillojnë sa më parë, vetëm me qëllim që projekti të përfundojë sipas planit dinamik të paraparë.¹⁹

Ekipi i Auditimit Social vizitoi vendpunishten e ndërtimit të murit mbrojtës pranë varrezave të qytetit. Gjatë monitorimit, ekipi vuri re se:

¹⁸ Xhylbehar Taipi_Menaxher i Kontratës_25.09.2025


¹⁹ Xhylbehar Taipi_Në takimin e ekipit të Auditimit Social me kryetarin Bexhet Xheladini_12.11.2025



Mungojnë shenjat dhe rrethojat për zonën e rrezikshme

Gjatë inspektimit të projektit, ekipi konstatoi se nuk janë vendosur shenja paralajmëruese dhe rrethoja mbrojtëse, të cilat janë të nevojshme për të parandaluar afrimin e qytetarëve dhe kafshëve në zonat e rrezikshme. Mungesa e këtyre elementeve përbën një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e përdoruesve dhe mund të shkaktojë aksidente ose dëmtime të mundshme.

Gjithashtu, projektit i mungon tabela informuese që përmban informacionin bazik mbi investimin, si përshkrimi i punimeve, objektivat dhe kontaktet përgjegjëse. Kjo mungesë kufizon transparencën e projektit dhe informimin e komunitetit për punimet dhe rreziqet e mundshme. Ekipi rekomandon vendosjen e shenjave paralajmëruese, rrethojave mbrojtëse dhe tabelës informuese, për të garantuar sigurinë, transparencën dhe qasjen e duhur të qytetarëve në zonën e projektit.



Hendeku pranë murit rrezikon shembjen e dheut në këtë zonë

Ekipi gjatë vizitës konstatoi që në mes murit dhe zonës është krijuar një hendek i cili krijon mundësinë e një shembjeje të dheut, duke rrezikuar edhe varrezat. Ekipi rekomandon që kompania implementuese sa më shpejtë të intervenojë për të mbushur hendekun dhe për të eliminuar mundësinë e rrëshqitjes së dheut në kohën e shirave. Gjatë bisedave me zyrtarët e komunës është evidentuar se projekti

parasheh që ky hendek të mbulohet pas disa ditësh kur betoni të jetë forcuar në vlerën e vet të fortësitë.

Nga Komuna e Dragashit kanë thënë se gjatë realizimit të punimeve ka pasur shenja që paraqesin rrezik nga shembjet.²⁰ Zona ka rrezik shembjeje mirëpo për këtë arsye ne kemi ndërtuar murin mbrojtës në këtë projekt.



Dëmtimi i asfaltit dhe mbeturina inerte

Gjatë vizitës në terren ekipi konstatoi se materialet inerte nuk janë larguar nga vendpunishtja ndërsa në disa vende asfalti

i zonës është dëmtuar nga punimet. Ekipi rekomandon që komuna të intervenojë duke kërkuar sanimin e dëmeve në projektet e tjera.



Mangësi në vendosjen e vrimave kulluese të murit

Gjatë vizitës, ekipi i Auditimit Social konstatoi po ashtu që vrimat kulluese në murin mbrojtës nuk janë vendosur me distancë të njëjtë. Nga vërtetimi u konstatua se disa nga vrimat janë të vendosura në distancë prej 2-metrave ndërsa në disa zona të tjera ato kalojnë 5-6 metra. Rekomandohet që komuna të intervenojë dhe të obligojë kompaninë t'i hapë vrimat.

Ekipi konstatoi po ashtu se një tub i kanalizimit i vendosur në zonë është duke rrezikuar projektin për shkak të erozionit dhe po dëmton trasenë e rrugës. Nga Komuna e Dragashit kanë thënë se ka vrima kulluese te muri ndërsa pjesën tjetër të gjetjes nuk e kanë komentuar.²¹

²⁰ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025

²¹ Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025



Punimet për ndriçimin në rrugën unazore në Dragash ende nuk kanë filluar

Gjatë inspektimit të këtij projekti, ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se kontrata është nënshkruar, por punimet në terren ende nuk kanë nisur. Kjo gjendje tregon një vonesë të dukshme në zbatimin e projektit, e cila mund të ndikojë negativisht në realizimin e objektivave dhe në përdorimin e mjeteve financiare të alokuara. Sipas deklarimeve të Menaxherit të Kontratës, planifikohet të vendosen shtyllat dhe rrjeta, me një pjesë të punimeve që do të realizohet brenda muajit: “Tash fillojmë edhe pak me punët fizike në teren, 18 shtylla i kemi edhe 336 metra rrjetë, brenda muajit.” Megjithatë, ekipi vlerëson se kjo nuk garanton nisjen e menjëhershme dhe të plotë të të gjitha punimeve të planifikuara, duke rrezikuar përkeqësimin e kushteve të punës për shkak të faktorëve atmosferikë dhe humbjen e mjeteve të investuara.

Duke marrë parasysh këto rrethana, ekipi rekomandon që punimet të fillojnë menjëherë, duke organizuar me prioritet të gjitha aktivitetet fizike në terren. Nisja e shpejtë e

punimeve do të sigurojë realizimin efikas të projektit brenda afateve të përcaktuara, do të parandalojë dëmtimin ose shkatërrimin e materialeve të përdorura dhe do të shmangë humbjen e mjeteve financiare. Përveç kësaj, fillimi i punimeve në kohë është i nevojshëm për të minimizuar ndikimin e kushteve atmosferike, të cilat mund të shkaktojnë vonesa të mëtejshme, dëmtime teknike dhe rritje të kostove të projektit. Ndërhyrja e menjëhershme është e domosdoshme për të garantuar cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e realizimit të projektit.

Nga komuna zotohen se ky projekt do të përfundojë brenda afatit të kontratës.”²²

Vlen të theksohet se kontrata për këtë projekt u nënshkrua më 30.07.2025 me Operatorin Ekonomik “Art Project” Sh.P.K, vlera e së cilës është 135,329.28 euro. Fillimi i punëve me kontratë është paraprare të nis 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës, ndërkohë të gjitha punimet të përfundojnë më 20.11.2025.

²² Komuna e Dragashit_përgjigje me shkrim_13.11.2025

PËRFUNDIME / REKOMANDIME



Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve

- Gjatë hartimit të projekteve, Komuna duhet të promovojë diskutimin e tyre në fazën e planifikimit, ashtu siç rekomandon Udhëzimi Administrativ për Transparencën Komunale.
- Gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore dhe hartimit të dokumenteve, Komuna duhet të ofrojë arsyttime të detajuara për pranimin ose refuzimin e projekteve investive.
- Në të ardhmen, Komuna e Dragashti duhet të publikojë projektet në detaje, dokumentet e menaxhimit të kontratës, faturat e paguara, punët e kryera dhe të paguara, ndryshimet e kontratës dhe arsyetimin e këtyre ndryshimeve.
- Komuna duhet të implementojë obligimin për vendosjen e tabelave informuese për projektet, duke bërë publik emrin e mbikëqyrësve të projekteve dhe kontaktet e tyre.
- Duhet të gjenden metoda alternative për të përfshirë më shumë gratë dhe personat me aftësi të kufizuar në dëgjimet dhe konsultimet buxhetore.




Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit

Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social, grupi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Procedurat e prokurimit të jenë në kohë, për të shmangur humbjen e fondeve nga donatorët dhe për të respektuar afatet e kontratave.
- Në projektet e planifikuara, të sigurohet qasja e personave me aftësi të kufizuar sipas standardeve.
- Projektet të planifikohen për të garantuar qëndrueshmëri afatgjate dhe të shmanget nevoja për intervenime të reja në anësore, mbrojtëse të urave dhe kanaleve të ujitjes.

Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social, ekipi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Mbikëqyrja e punimeve të jetë aktive dhe të sigurojë që puna të realizohet sipas projektit dhe standardeve.
- Punët jocilësore të mos pranohen nga komuna dhe kompanitë të obligohen t'i sanojnë dëmet.
- Mbetjet inerte të largohen nga zona nga kompanitë të cilat i kanë kryer punimet.
- Dëmet në infrastrukturën tjetër të sanohen nga kompanitë kontraktuese para mbylljes së kontratave.
- Sinjalistika rrugore duhet të ketë vëmendje të veçantë gjatë mbikëqyrjes.
- Vendosja e shenjave paralajmëruese dhe barrierave mbrojtëse në të gjitha vendpunishtet publike dhe rrugët ku zhvillohen punime.
- Vendosja e udhëzimeve të qarta për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet potenciale në vendpunishtet.



METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde

të paracaktuara përzgjedhi 16 projekte në 6 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social. Në kuadër të procesit të Auditimit Social u përfshinë 16 projekte në gjashtë komuna.

Emri i projektit	Komuna	Vlera	Faza e projektit në nisjen e auditimit
Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë	Drenas	497,724.00 €	Implementim
Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë	Drenas	299,652.50 €	Implementim
Rehabilitimi rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak	Drenas	700,000.00 €	Tenderim
Instalimi i paneleve solare në kulmin e objekti të Komunës	Drenas	17,812.32 €	Tenderim
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet - Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	Kaçanik	241,111.11 €	Implementim
Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj	Kaçanik	260,885.45 €	Implementim
Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad	Dragash	80,299.82 €	implementim
Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Dragash	101,994.69 €	Implementim
Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash	Dragash	135,329.28 €	Implementim
Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)	Dragash	122,219.00 €	Tenderim
Ndërtimi i Shtratit të Lumit Istog dhe Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	Istog	Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 € (Shtrati i lumit) 301,155 € (rrugët)	Tenderim Implementim

Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE-për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)	Mamushë	52,333.66 €	Tenderim
Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)	Lipjan	59,925.88 €	Implementim
Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	Lipjan	121,555.55 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi	Lipjan	267,381.95 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturovc dhe Ribar i Madh	Lipjan	266,715.00 €	Implementim

Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?

Grupi i Auditimit Social është një grup i qytetarëve të cilët në mënyrë vullnetare i përgjigjen nismës për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të komunitetit, BIRN dhe D+ në bashkëpunim me OJQ-të lokale partnere të projektit, hartuan një listë me profesione dhe përfaqësues të komunitetit, të cilët u ftuan për t'ubashkëngjitur në grup.

Në kriteret e përzgjedhjes u përcaktua se grupi synonte t'u jepte prioritet përfshirjes së kategorive të marginalizuara të shoqërisë siç

janë gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet joshumicë. Synohej që grupi të kishte laramani të profesioneve dhe moshave me qëllim të garantimit të gjithëpërfshirjes.

Ekipet e OJQ-ve partnere të projektit nën fasilitimin e BIRN dhe D+ kontaktuan mbi 200 qytetarë nga 6 komunat për t'i ftuar ata që të bëhen pjesë e grupeve. Mbi 120 qytetarë nga komunat e synuara u bënë pjesë e grupeve.

Në Dragash u themelua grupi me 20 qytetarë, të cilët kanë punuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërkoi informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizoi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita

në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Dragashit.

Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 20 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar OJQ AVOKO në Dragash, me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të BIRN. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Dragashit.


Validimi i të dhënave

Ekipi i Auditimit Social në Dragash ka punuar në identifikimin e problemeve në projektet që janë implementuar në këtë komunë për të shkruar raportin. Në takimet e mbajtura ekipi u dakordua për gjetjet sistematike në dy projektet dhe për gjetjet specifike të projekteve individuale. Ekipi u dakordua

edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me kryetarin e komunës dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin për komente eventuale.

Përbërja e ekipit

Përbërja e ekipit: 20 anëtarë, 4 gra apo 20% dhe 16 burra apo 80 %



Ekonomist; Jurist; Punëtor/Ndërtimtari; Teknik IT; Tregtar; Ekonomist/Student; Inxhinier/Student; Profesor i Matematikës; Student; Profesor i Teknologjisë; Master i Matematikës; Profesor i Gjuhës Shqipe; Profesor i Edukimit Fizik; Pensionist; Afarist/OJQ "Liqeni i Breznës"

Aktivitetet e grupit të Auditimit Social

Gusht 2025	<ul style="list-style-type: none"> Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Dragashit Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale
Shtator 2025	<ul style="list-style-type: none"> Trajnimi për OJQ-të lokale, partnere të projektit Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social nga OJQ AVOKO në Dragash Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën e Dragashit Trajnimi i ekipit të Auditimit Social Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber Pranimi i përgjigjeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Komuna e Dragashit Trajnimi, diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga komuna Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social në projektet për monitorim Takimi i ekipit me Menaxherët e Kontratave
Tetor 2025	<ul style="list-style-type: none"> Vizita e radhës në teren e ekipit të Auditimit Social Takimi i ekipit për dakordimin e gjetjeve dhe rekomandimeve finale në draftimin e raportit Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit Ndarja e detyrës për shkrimin e raportit për kryesuesin e ekipit të Auditimit Social, nga OJQ AVOKO Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social

EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË DRAGASH

Nr.	Emri / Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Mitat Krasniqi	Ekonomist
2	Besim Qengaj	Jurist
3	Ramadan Berisha	Punëtor/Ndërtimtari
4	Agron Spahiju	Teknik IT
5	Tahir Berisha	Tregtar
6	Asllan Krasniqi	Ekonomist/Student
7	Fadil Halimi	Profesor i Matematikës
8	Lavdim Sadiku	Student
9	Besar Piraj	
10	Vaneta Gerdellaj	Studente
11	Zanfina Qellopeku	Studente
12	Diesa Qellopeku	Studente
13	Semina Misini	Studente
14	Admir Halimi	Profesor i Teknologjisë
15	Vajdin Ademi	Master i Matematikës
16	Fisnik Guri	Profesor i Gjuhës Shqipe
17	Xhemal Iljazi	Profesor i Ed.fizike
18	Ezan Qengaj	Inxhiner/Student
19	Hajri Gashi	Pensioner
20	Erim Krasniqi	OJQ "Liqeni i Breznës"

LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT

*Të nderuar qytetarë të Dragashit,
Të respektuar partnerë të projektit “Auditimi Social”,*

Për mua dhe për institucionin që përfaqësoj është kënaqësi e veçantë që Komuna e Dragashit është përfshirë në një nismë që vendos qytetarin në qendër të vlerësimit të punës sonë. Projekti “Auditimi Social”, i zbatuar nga BIRN dhe DEMOS, në bashkëpunim me OJQ “Avoko” në Dragash, ka hapur një kapitull të ri në mënyrën se si e kuptojmë përgjegjësinë publike dhe menaxhimin e projekteve infrastrukturore.

Në kuadër të këtij projekti janë audituar katër projekte infrastrukturore të realizuara në Komunën tonë. Këto projekte janë zgjedhur për të vlerësuar mënyrën se si investimet komunale ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës dhe në cilësinë e jetës së banorëve të Dragashit. Procesi i auditimit na ka ndihmuar të kuptojmë më qartë se si mund të rrisim efektivitetin, transparencën dhe ndikimin pozitiv të punës sonë në terren.

Ky projekt ka sjellë vlera të reja në qeverisjen lokale, duke na ndihmuar të kuptojmë më mirë pritjet e komunitetit, të matim rezultatet e arritura dhe të identifikojmë hapësirat ku mund të bëjmë më shumë.

Raporti i dalë nga ky proces i auditimit nuk është vetëm një raport teknik, por një mësim për të gjithë ne, që na ka treguar se transparenca dhe bashkëpunimi me qytetarët nuk janë detyrime formale, por themele mbi të cilat ndërtohet besimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm lokal. Përmes pjesëmarrjes së qytetarëve, kemi marrë ide, komente dhe vërejtje që do të na ndihmojnë të planifikojmë më mirë projektet e ardhshme.

Puna e përbashkët me organizatat partnere ka dëshmuar se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile sjell rezultate konkrete. Falë këtij partneriteti, Komuna e Dragashit ka fituar përvojë dhe njohuri që do të përdoren për të ngritur edhe më lart standardet e qeverisjes sonë lokale.

Të dashur bashkëqytetarë,

Përkushtimi ynë është të ndërtojmë një komunë që dëgjon, që tregon kujdes për secilin qytetar dhe që vepron me përgjegjësi për çdo vendim e investim që ndërmarrim. Auditimi social është vetëm një prej hapave në këtë drejtim dhe rezultatet e tij do të jenë udhërrëfyes për projektet e ardhshme. Rekomandimet e dalura nga ky proces të cilat janë bazuara, Komuna e Dragashit shpreh gatishmërinë e saj që t’i zbatojë gjatë punës së vazhdueshme të qeverisjes lokale.

Në emër të Komunës së Dragashit, falënderoj të gjithë ata që kontribuuan në këtë proces, nga qytetarët pjesëmarrës e deri te ekspertët e angazhuar. Së bashku po ndërtojmë një Dragash më të drejtë, më të hapur dhe më të zhvilluar.

*Me respekt,
Bexhet Xheladini
Kryetar i Komunës së Dragashit*

LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E DRAGASHIT




Procesi i Auditimit Social në Komunën e Dragashit ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe për të forcuar bashkëpunimin me institucionet lokale. Gjatë trajnimeve dhe punës në terren, ekipi jonë ka kuptuar qartë rëndësinë e këtij procesi në identifikimin e nevojave reale të komunitetit dhe në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Gjatë monitorimit, gjetjet kryesore janë fokusuar në infrastrukturën e lëvizjes dhe sigurisë publike, sidomos në disa segmente të rrugëve dhe trotuareve, ku është evidentuar nevoja për ndërhyrje për shkak të mungesës së qsjes dhe sigurisë për këmbësorët. Po ashtu, muri mbrojtës në disa zona përbën një çështje shqetësuese, sidomos gjatë kushteve atmosferike të pafavorshme, ndërsa ndriçimi përgjatë rrugës unazore është identifikuar si një prioritet për sigurinë e qytetarëve në orët e mbrëmjes.

Ne besojmë se këto gjetje përfaqësojnë shqetësimet reale të banorëve, dhe adresimi i tyre do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe lëvizjes në hapësirat publike të qytetit. Roli i komunitetit në këtë proces ka qenë thelbësor, duke dëshmuar se përfshirja qytetare sjell rezultate konkrete dhe kontribuon në planifikim më të përgjegjshëm dhe më të qëndrueshëm.

Jemi të bindur se vazhdimi i Auditimit Social në Komunën e Dragashit do të ndihmojë në rritjen e transparencës institucionale dhe në forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes vendore, duke hapur rrugë për projekte më funksionale dhe më afër nevojave të komunitetit.



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige